

Mirëmëngjesi,

Të nderuara anëtare të RrGK,

Është një nder i veçantë të hapi sot Kuvendin vjetor të Rrjetit të grave të Kosovës, me ju, gra të shquara, aktiviste nga të gjitha viset e Kosovës dhe nga të gjitha fushat e jetës, që me sakrificat të mëdha, me punë e me dije, dhe me vendosmëri e keni ndryshuar vetveten nga të mbijetuara të luftës me përmasa të gjenocidit, në luftëtare të pa kompromis për të ndërtuar Kosovën si një vend i lirë, ku secili individ, të ketë mundësi të jetojë në mirëqenie e me dinjitet, pa diskriminim, ku barazia dhe mundësitë e barabarta i garantohen gjithsecilit.

Përkundër përparimeve, sidomos këto vitet e fundit, edhe ky takim sot është një moment për të përgëzuar përparimet, për të reflektuar mbi plagët e pashëruara dhe për të riafirmuar angazhimin tonë për një të ardhme ku gratë të jenë të sigurta, të barabarta dhe të përfaqësuara në çdo vendimarrje.

E kaluara, e tashmja dhe e ardhmja janë të ndërlydhura. Kur flasim për drejtësinë, nuk mund ta anashkalojmë drejtësinë tranzicionale. Po, tash më në fund e kemi edhe Strategjinë e parë shtetërore për drejtësi tranzicionale që vërtetë është një hap i rëndësishëm. Por një strategji, sado e mirë në letër, mbetet e pamjaftueshme nëse nuk përkthehet në drejtësi konkrete. Dhe kjo është veçanërisht e vërtetë për gratë viktimat të dhunës seksuale gjatë luftës.

Të nderuara pjesëmarrëse,

Rrugëtimi për njohjen ligjore të statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale ka qenë i gjatë dhe i dhimbshëm dhe u bë i mundur vetëm me vendosmërinë e Presidentes Jahjaga, me angazhimin e madh të grave dhe aktivizmin e Rrjetit, që përmes themelimit të Këshillit Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës, të bëheshin më në fund ndryshimet ligjore që mundësuan njohjen zyrtare të statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale. Edhe pse ligji u miratua në vitin 2014, përpjekjet për status ligjor ishin shumë më të hershme dhe përballën me rezistencë të fortë në Kuvendin e Kosovës, madje edhe nga disa gra deputete. Stigma ishte atëherë jo vetëm shoqërore, por edhe institucionale.

Dhe, kjo stigmë institucionale, na ka lënë një pasojë vështirë të ndreqshme, mos përfshirjen e kësaj plaje të luftës në dialogun me Serbinë të lehtësuar nga Bashkimi Evropian!

Sot, edhe pse mbi 1,600 të mbijetuara kanë arritur të fitojnë statusin dhe një shume modeste të kompensimit mujor, stigma shoqërore vazhdon të jetë e fortë. Shumë gra ende hezitojnë të aplikojnë nga frika e paragjykitimit. Ndërkohë, vlerësohet se numri real i viktimave është shumë më i madh – deri në dhjetëra mijëra – çka tregon për hendekun e madh ndërmjet drejtësisë formale dhe realitetit.

Përtej këtyre sfidave ligjore dhe sociale, shumë prej këtyre grave përballen edhe me vështirësi të rënda ekonomike. Mundësitë për punësim janë të kufizuara, varfëria është e vrazhdë dhe mbështetja financiare shpesh nuk mjafton për një jetë me dinjitet. Edhe organizatat e grave, që kanë qenë shtylla kryesore e mbështetjes, vazhdojnë të përballen me mungesë të financimit të qëndrueshëm.

Nuk mund të injorojmë as sfidat e së tashmes. Dhuna ndaj grave vazhdon, dhe në rastet më ekstreme përfundon në femicid. Muajt e fundit kemi parë dënime më të ashpra dhe maksimale për autorët – një hap përpara që është arritur falë aktivizmit të palodhur të grave të organizuara në RrGK.

Ky aktivizëm ka qenë vendimtar. Ai ka thyer heshtjen, ka sfiduar institucionet dhe ka sjellë ndryshime konkrete.

Në dy dekadat e fundit, në vendin tonë janë bërë hapa të rëndësishëm: kemi arritur suksese të mrekullueshme të vajzave në arsim, fatkeqësisht përparim më të ngadalësuar të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe pjesëmarrje shumë më e madhe e grave në jetën publike; ekziston një kuadër ligjor i avancuar dhe politika të mira për barazinë gjinore; dhe aktivizmi i juaj ka bërë të mundur ndryshime konkrete në institucione dhe në praktikë.

Këto ndryshime nuk janë bërë vetvetiu. Secila prej jush veç e veç dhe të gjitha së bashku nën ombrellën e rrjetit, me shumë përpjekje e sakrificë kemi arritur që të mbërrijmë deri këtu.

Megjithatë, arritjet në letër duhet të përkthehen në drejtësi konkrete dhe në ndryshim real për jetët e grave. Po ashtu, duhet të kujtojmë se demokracia dhe respekti për gratë nuk përfundojnë në ligje vetëm — ato kërkojnë kulturë institucionale dhe sjellje të përditshme që mbrojnë dinjitetin e secilës.

Kohët e fundit pamë një shembull të qartë se pse kjo është e rëndësishme: në Kuvend u përdor gjuhë denigruese dhe seksiste ndaj një deputeteje. Një sjellje e tillë nuk është përplasje politike e thjeshtë — është një kërcënim për pjesëmarrjen e grave dhe për besimin e qytetareve që duan të angazhohen shoqërisht dhe politikisht. Duhet të përsëritet reagimin e vendosur të Kryetares së Kuvendit, Znj. Albulena Haxhiu, e cila dënoi ashpër këtë gjuhë. Ky qëndrim institucional ishte mesazh i qartë se dinjiteti nuk është çështje partie, por themeli i çdo institucioni demokratik.

Deri te ky rast, fyerja e grave deputete, dënohej vetëm nga organizatat e grave dhe pjesëtarë të tjerë të shoqërisë civile dhe bashkë partiakët. Kjo tregon edhe se sa është e rëndësishme që të kemi gra në krye të institucioneve.

Nuk ka dyshim: gratë si modele të fuqishme në jetën publike janë thelbësore për një demokraci të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse. Një fëmijë që rritet duke parë gratë në krye të institucioneve kryesore, rritet me një kuptim më të thellë të barazisë.

Kjo është e ardhmja drejt së cilës ne bashkërisht angazhohemi.

Dhe nuk jemi ende atje. Progresi mbetet i brishtë. Dhe për shumë gra, pabarazia ka të bëjë edhe me sigurinë. Numri i grave që përjetojnë dhunë dhe nuk ia thonë askujt, është ende shumë i madh. Numri i grave që përballen me ngacmime seksuale në punë, e nuk ia thonë askujt, vazhdon të jetë i madh. Dhuna seksuale është një krim që ende mbetet në errësirë nga tabutë. Për shkak të fajësimit të viktimave dhe stigmës, shumë vajza dhe gra vazhdojnë të jetojnë me turp dhe me frikë dhe e fshehin krimin ndaj tyre. Dhunuesit jetojnë të lirë. Krimi nuk raportohet, mbulohet dhe shumë shpesh autorët lihen të lirë. Ne e shohim çdo ditë dëmin e madh që shkakton dhuna seksuale dhe ajo me bazë gjinore: si fizike ashtu edhe psikologjike. Shumë shpesh kryhet me qëllim për të dehumanizuar dhe degraduar. Vërtetë duhet bërë më shumë. Gratë që janë sot këtu e dinë, kanë përvojë dhe vullnet për tu angazhuar, por mundësitë financiare, përkundër mbështetjes institucionale janë shumë të kufizuara. Bashkërisht, duhet të bëjmë më shumë, të gjejmë më shumë mundësi për të ngritur fonde për të organizatat e grave që punojnë në komunitet për të adresuar këtë plagë të madhe të shoqërisë sonë.

Le të shërbejë ky moment si një pikë kthese: për të forcuar institucionet tona, për të mbrojtur gratë në politikë, ekonomi dhe në shoqëri dhe në shtëpi. Ne kemi detyrimin moral dhe kombëtar të veprojmë, së bashku dhe pa vonesë.

Ju faleminderit.